



*Prishtinë, 13 shtator 2017*

## **NJOFTIM**

### **SEANCË PËR DISKUTIM PUBLIK**

#### **Shqyrtimi i dytë Periodik Rregullativ (SHPRR 2) për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR)**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) njofton të gjitha palët e interesuara se më 19 shtator 2017, duke filluar nga ora 10:00, në Hotel "Swiss Diamond" do të organizohet Seancë për **Diskutim Publik** lidhur me Shqyrtimin e dytë Periodik Rregullativ (SHPRR 2) për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), Operatorin e Tregut (OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për Periudhën Rregullative 1 prill 2018 - 31 mars 2023.

Procesi i Shqyrtimit të Periudhës së dytë Rregullative është iniciuar nga ZRRE më 4 korrik 2017, ku janë publikuar për diskutim Raporti Konsultativ për Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC), Raporti për Vlerësimin e Jetëgjatësisë së Aseteve dhe Raporti Konsultativ për Reduktimin e Humbjeve. Pas marrjes së komenteve nga palët e interesuara, në lidhje me raportet, dhe pas dorëzimit të kërkesave nga operatorët e licencuar, ZRRE në këtë Seancë ka për qëllim t'ju ofroj mundësi të gjithë të interesuarve që të japin komentet e tyre në lidhje me kërkesat e të licencuarve. Të licencuarit në këtë seancë, përveç të tjerash, do të paraqesin çështjet thelbësore të kërkesave të tyre, siç janë parashikimet për kërkesën e energjisë, shitjet dhe humbjet e energjisë, investimet kapitale si dhe shpenzimet operative dhe ato të mirëmbajtjes për periudhën e ardhshme rregullative SHPRR 2.

Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) të tanishme janë përcaktuar në Shqyrtimin e parë Periodik në vitin 2013 (PRR 1) dhe janë në fuqi deri në vendimin e ardhshëm të Bordit të ZRRE, i cili pritet të merret deri para përfundimit të Periudhës së parë Rregullative.

***Lusim të gjitha palët e interesuara që pjesëmarrjen e tyre në seancë ta konfirmojnë në adresën elektronike [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org).***